Në bashkëpunim me Tourism and Marketing Institute (TMI) dhe me përkrahjen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), trajnuam pjesëmarrëset për të promovuar turizmin rural dhe marketingun e produkteve lokale.

Është realizuar vizitë biznesit fantastik "Gollaku Food," ku pamë nga afër procesin e tharjes dhe përpunimit të pemëve dhe perimeve

Së bashku me trajnuesen dhe këshilluesen dhe pjesëmarrëset tjera u inspironam nga suksesi i këtij biznesi lokal që po kontribuon në ekonominë e vendit tonë!

10. Organizimi i panairit të grave ndërmarrëse në kuadër të fushatës "16 Ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore" në Kamenicë

11. Dita e Solidaritetit në Kamenicë: Frymëzim dhe bashkëpunim për të rinjtë dhe komunitetin

Komuna e Kamenicës ka shënuar Ditën e Solidaritetit me një nismë të merkullueshme të realizuar falë bashkëpunimit të shkëlqyer me OJQ-në "Toka" dhe Gjimmazin "Ismail Qemali" në Kamenicë.

Në këtë ditë, nxënësit patën mundësinë të angazhohen në biznese lokale, duke fituar përvoja të reja dhe duke dhënë kontributin e tyre për të mirën e komunitetit. Të ardhurat dhe mbështetja e siguruar gjatë këtij projekti do të përdoren për bamirësi ose për të fuqizuar projekte që ndihmojnë zhvillimin e mëtejshëm të të rinjve tanë.

Bizneset që dhanë kontributin e tyre janë: Restaurant Oda, Agjensioni Turistik Përparimi, Etc, Viva Fresh Store, ChaplinBar, Joni Ranch, Buffi, Begi dekor, Fungo, SunBar, Besa Center, Driloni, Restaurant Panorama, Zdruktharia Përparimi..

12. Përruhet Lulishja "Luludi" në Kamenicë

Një ide e shprehur nga të rinjtë të komunitetit rom e cila është realizuar në kuadër të projektit ROMACTED II, bashkëpunim ky mes Komunitetit të Kamenicës dhe Këshillit të Europës.

Kjo është një nisim shumë i mirë, e cila do t'i japë pamje tjetër Kamenicës, një biznes i tillë nuk ka qenë më herët në komunën tonë. Në kuadër të projektit ROMACTED II, është shënuar edhe Dita e Komunitetit Rom në Kamenicë.

13. Takim me Arianita Bega-Rraci, zyrtare për komunitetin nga Kombet e Bashkuara.

Tema e diskutimit mbi projektet e përbashkëta që mund të realizojmë në vitin 2025, me fokus të veçantë tek rinia.

14. Organizimi i eventit të fundvitit me biznese lokale

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme:

QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË (FISNIK KASTRATI)

Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

01/06/2024 - 29/11/2024

| Shkurtesa | Pershkrimi | Pranuar | Ne Proces | Miratuar | Refuzuar | Hedhur Poshte | Pezulluar | Ceduar | Anulluar | Perfunduar | Totali |
|---------------|---|---------|--------------|----------|----------|------------------|-----------|--------|----------|------------|--------|
| | NUK EXISTON si DEPARTAMENT por ka Lende | 0 | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 |
| DAP | Drejtoria e Administratës së Pergjithshme | 5 | 73 | 1,294 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 11,678 | 13,055 |
| DA | Drejtoria e Arsimit | 8 | 1 | 467 | 44 | 2 | 0 | 1 | 4 | 0 | 527 |
| DBPZHR | Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | 2 | 67 | 216 | 77 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 362 |
| DEFZH | Drejtoria e Financave dhe Buxhetit | 3 | 268 | 10 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 283 |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|--------------|---|---|-----|-----|----|---|---|---|---|---|---|---|-----|-----|
| DKRS | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 0 | 33 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 33 |
| DPKGJ | Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë | 5 | 17 | 137 | 2 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 162 |
| DI | Drejtoria e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Diaspores | 1 | 8 | 27 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 37 |
| DSHMS | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 1 | 227 | 38 | 28 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 295 | |
| DSHPA | Drejtoria e Shërbimeve Publike Ambientit dhe Inspektoriatit | 8 | 80 | 236 | 59 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 383 | |

| | | | | | | | | | | | | |
|-------------|---|-----|-------|-------|-----|---|---|---|----|--------|---|--------|
| DUPH | Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapsinor | 3 | 363 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 370 |
| DMSH | Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit | 0 | 9 | 11 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 22 |
| KKK | Kuvendit Komunal | 0 | 115 | 25 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 0 | 144 |
| KKK | Zyra e Kryetarit | 65 | 1,684 | 1,510 | 192 | 0 | 0 | 1 | 12 | 0 | 0 | 3,464 |
| | | 101 | 2,952 | 3,974 | 405 | 2 | 0 | 3 | 29 | 11,678 | 0 | 19,144 |

SEKTORI I GJENDJES CIVILE (HYRJJE DËRVODELI - KRASNIOI)

Dokumentet e lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile

01.06.2024 – 29.11.2024

| LLOJI I DOKUMENTIT | |
|--|------|
| Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile | 5829 |
| Certifikatë lindje | 3270 |

| | |
|--|-------|
| Certifikatë martesë | 1364 |
| Certifikatë vdekje | 801 |
| Aktivdekje | 108 |
| Certifikatë vendbanimi | 923 |
| Certifikatë të bashkësisë familjare | 1037 |
| Certifikatë të gjendje martesore | 332 |
| Certifikatë shtetësie | 93 |
| Lëshimi i vërtetimeve të gjendjes civile nga arkivi | 186 |
| Lëshimi i dokumenteve nga arkivi i Komunës | 15 |
| Konfirmime / Vërtetime | 14 |
| Pranim Atësie | 3 |
| Deklarata për kthim te mbiemrit brenda 6 muajve | 7 |
| Procedura mbi 18 vjet regjistrim | 24 |
| Persona mbi 90 vjet | 10 |
| Përgjigje Gjykatave | 13 |
| Përgjigje divizionit te Pensioneve | 5 |
| Aplikim për fitim të shtetësisë | 42 |
| Aplikim për lirim të shtetësisë | 4 |
| Numri i gjetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror të gjendjes civile dhe shërbim: | 13835 |

| | |
|----------------|-------|
| Totali: | 14081 |
|----------------|-------|

Veprimet – Procedurat e zhvilluara administrative: lindjet, martesat, vdekjet dhe vendime

01.06.2024 – 29.11.2024

| LLOJI I DOKUMENTIT | |
|--|----|
| Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, brenda vendit : | |
| Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, jashtë vendit : | 55 |
| Martesat e lidhura dhe rishkrim martesë: | 20 |
| Shkurorëzimet : | 5 |

| | |
|---|------------|
| Martresat me element të huaj : | 9 |
| Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda vendit : | 8 |
| Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit: | 3 |
| Mjete jetese | 35 |
| Vendime për korrigjime në emra personal : | 1 |
| Vendime për ndërrime në emra personal : | 1 |
| Totali: | 137 |

NJËSIA KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

- **Me rastin e 1 Qershorit** Koordinatorja e NJKDNJ-së, bashkë me Drejtorin e DKA-së dhe Asamblienë Komunale të Fëmijëve kanë përgatitur një videomesazh për të Drejtat e Fëmijëve. Ky video-spot jep një mesazh për të gjithë shoqërinë që fëmijët janë gjëja më e shtrenjtë dhe për të duhet punuar sa më shumë në mënyrë që tua krijojmë mundësitë që të jetojnë një jetë të dinjitetshme me respektimin e të drejtave të tyre (1 qershor 2024)
- **Njoftim për Platformen www.raportodiskriminimin.org** Përmes publikimit në rrjetet sociale Koordinatorja e NJKDNJ-së ka njoftuar qytetarët sa i përket platformës www.raportodiskriminimin.org e cila mundëson raportimin e rasteve të diskriminimit, përfshirë edhe martesat e hershme, në mënyrë konfidenciale. Kjo platformë është një mjet i rëndësishëm për qytetarët që të denoncojnë raste të tilla dhe për ne që të ndërmarrim veprime të duhura (3 korrik 2024)
- **Koordinatorja e NJKDNJ-së, Nazmije Demolli-Kastrati e Certifikuar nga NDI për Leadership Gjithëpërfshirës** - Koordinatorja e NJKDNJ-së, mori pjesë në Javën e Gruas 2024, organizuar nga NDI. Ngjarja u hap më 19 dhe 20 mars me temën "Udhëhiq me Gjithëpërfshirje: Ndërtuarja e Politikës me Ekonominë". Aktivitetet vazhduan me debate në pesë komuna (Gjilan, Klinë, Dragash, Skënderaj, Prishtinë) dhe përfunduan me një konferencë përmbyllëse, mbështetur nga USAID e SDC (17 shtator 2024).
- **Dita Ndërkombëtare e Njerëzve të Moshuar** - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Njerëzve të Moshuar, Nazmije Demolli-Kastrati, Koordinatorja e NJKDNJ-së, dhe Kosovare Maroca Berisha, Zyrtare për Barazi Gjinore, vizituan Shoqatën e Pensionistëve në Kamenicë, ku u pritën nga Kryetari Milit Thaçi sekretari Zija Hashani dhe Hafiz Krasniqi. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve zyrtaret e NJKDNJ-së shprehën vlerësimin e thellë për kontributin dhe sakrificën e gjithë personave të moshës së tretë në ndërtimin e shtetit. Gjatë ditës, janë shpërndarë fletëpalosje për ngritjen e vetëdijes mbi çështjet që prekin të moshuarit (1 tetor 2024)
- **Hapja e Fushatës Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore** - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Komuna e Kamenicës, përmes Koordinatorës së Njesisë për të Drejtat e Njeriut, dhe Zyrtares për Barazi Gjinore ka nisur një fushatë ndërgjegjësuese kundër

trafikimit me genie njerëzore. Fushata filloi me një vizitë në Stacionin Policor të Kamenicës, ku ato u pritën nga komandanti Florim Klaiqi, me bashkëpunëtorë. Mesazhi: 'Trafikimi prek të gjithë! Le të mbrojmë veten dhe fëmijët tanë!' (18 tetor 2024)

Trajtimi i ankesave të qytetarëve nga ana e IAP. Aktiviteti: "Ditë e hapur me qytetar -

Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim NJKDNJ-në, kanë mbajtur aktivitetin "Ditë e hapur me qytetarë", takim ky i cili mbahet një herë në muaj në Komunën e Kamenicës.

Gjatë kësaj dite qytetarët kishin mundësi t'i parashtrajnë Avokatit të Popullit ankesat e tyre, që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut (Një herë në muaj)

- **Ligjërata Vetëdijësuese për Ndërgjegjësimin mbi Kancerin e Gjirit -** Kryesuesja e Grupit të Grave të Komunës së Kamenicës në bashkëpunim me Zyrtaren për Barazi Gjimore dhe Koordinatorin për të Drejtat e Njeriut dhe QKMF-në, organizuan ligjërata vetëdijësuese për ndërgjegjësimin rreth sëmundjes së Kancerit të Gjirit në fshatin Hodonoc. Në këtë tryezë frymëzuese, u bashkuan gra që janë të prekura nga kjo sëmundje e po ashtu ato që kanë arritur ta përballojnë dhe triumfojnë mbi këtë sfida. Tregimet e tyre janë dëshmi e forcës dhe guximit që ne të gjitha bartim! Pas kësaj, u zhvillua një sesion informues dhe vetëdijësues ku morën pjesë shumë gra, përfshirë edhe ato nga Lugina e Preshevës. Të gjitha së bashku ndamë njohuri të rëndësishme dhe mbështetje, duke ndihmuar njëra-tjetrën të bëjmë më të mirën për shëndetin tonë! (22 tetor 2024).

- **Ligjërata ndërgjegjësuese në SHFMU "Falk Konica", mbi parandalimin e trafikimit me genie njerëzore** – Në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit për Parandalimin e Trafikimit me Genie Njerëzore, SHFMU "Falk Konica" në Prishtinë organizoi një ligjërata ndërgjegjësuese, me pjesëmarrjen e znj. Nazmije Demolli Kasirati, Koordinatorë e Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut në Kamenicë "Trafikimi është një fenomen që prek të gjithë! Të mbrojmë veten dhe fëmijët tanë! Mos hesht! Parandallo trafikimin me njerëz," ishte mesazhi kryesor që u përcoll nëpërmjet videosportit të prezantuar nga

zgj. Demolli Kasrati. Ligjëratarës iu bashkua edhe zgj. Luajeta Ibishi Ferizi, Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Njeriut pranë MAPL-së dhe anëtare e Autoritetit Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz, e cila diskutoi rolin kyç të institucioneve qendrore dhe autoriteteve kombëtare në parandalimin e kësaj dukurie të mezikshme.

Qëllimi i kësaj fushate ishte të trajtojë sfida aktuale dhe të ofrojë strategjitë më efektive për parandalimin e këtij fenomeni shqetësues (23 tetor 2024)

- **Thirrje për Ndërgjegjësim dhe Veprim: Mbrojtja e të Miturve nga Dhuna dhe Abuzimi seksual** - Koordinatorja e NJKDNI-së përmes një shkrimi në rrjetet sociale bëri thirrje për Ndërgjegjësim dhe Veprim: Mbrojtja e të Miturve nga Dhuna dhe Abuzimi seksual. Qëllimi i thirrjes ishte ngritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e mbrojtjes së të miturve nga dhuna dhe abuzimi, si dhe mobilizimi i të gjithë faktorëve shoqërorë për të edukuar dhe ndërhyrë në mënyrë efektive për të parandaluar këto fenomene (3 nëntor 2024)

- **Fushatë ndërgjegjësuese për Parandalimin e TQNJ** - Me rastin e Muajit të Ndërgjegjësimit për Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, Koordinatorja e NJKDNI-së, e shoqëruar nga Zyrtarja për Barazi Gjinore, mbajti një ligjërata informuese me nxënësit e shkollës së mesme "IAAP Andrea Durrësaku" në Kamenicë. Përmes mesazhit kryesor të aktivitetit, "Trafikimi prek secilin prej nesh! Të mbrojmë veten dhe fëmijët tanë! Mos heshti! Parandalo trafikimin," zgj. Demolli Kasrati u përpoq të nxisë vetëdijen mbi rëndësinë e mbrojtjes nga ky fenomen (7 nëntor 2024)

- **Vazhdon Fushata për Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore** - Në vazhden e aktiviteteve të Muajit të Ndërgjegjësimit për Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut në Kamenicë, organizoi një ligjërata ndërgjegjësuese për nxënësit e klasave VIII dhe IX në SHFMU "Dëshmorët e Kombit" në Kamenicë. Gjatë takimit, u zhvillua një diskutim i hapur mbi trafikimin, dukuritë negative, dhunën në familje dhe sfida tjera që kërcënojnë mirëqenien e komunitetit (8 nëntor 2024)

- **Të Drejtat e Njeriut dhe Parandalimi i dukurive negative - Sesion Ndërgjegjësues për nxënësit - Ky aktivitet, i mbajtur në SHFMU “Avdullah Krashnica - Presheva” në Koretin, u zhvillua në bashkëpunim me Avokatit e Popullit dhe Njësinë Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJKDNJ), i cili kishte për qëllim informimin e nxënësve rreth temave të rëndësishme si të drejtat e njeriut dhe parandalimi i dukurive negative, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë trafikimit të qenieve njerëzore (19 nëntor 2024)**

- **20 nëntori – Përvjetori i Konventës për të Drejtat e Njeriut - 20 nëntori shënon Ditën Universale të Fëmijëve dhe përvjetorin e miratimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (1989). Kjo ditë nënvizon rëndësinë e mirëqenies dhe të drejtave të barabarta për të gjithë fëmijët. Koordinatorja e NJKDNJ-së, përmes një shkrese drejtuar Drejtorisë Komunale të Arsimit ka kërkuar që të gjitha shkollat e komunës së Kamenicës, të realizohen aktivitete të ndryshme gjatë që është miratuar kërkesa nga DKA ngase këto aktivitete pasqyrojnë përkushtimin për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave që garanton Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (20 nëntor 2024)**

- **Takimi i Parë Konsolidues i Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve - Koordinatorja e NJKDNJ-së mbajti takimin e parë konsolidues të Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve, me pjesëmarrjen e anëtarëve të ekipit dhe përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave relevante.**

Në takim morën pjesë edhe: Znj. Luljeta Ibishi Ferizi, Zyrtare e Lartë për Avancimin e të Drejtave të Njeriut pranë MAPL-së, Z. Naser Lajqi, Udhëheqës i programeve për mbrojtjen e fëmijës OIQ “Syri i Vizionit”. Takimi përmbylli diskutime të frytshme dhe u theksua rëndësia që të gjithë anëtarët e ekipit të jenë pjesë aktive e procesit të punës, duke siguruar përmbushjen e obligimeve dhe angazhimin maksimal në mbrojtjen dhe avancimin e të DF (21 nëntor 2024).

Lulishja “Luludi”: Një Hap i Madh për Kamenicën dhe Komunitetin Rom - Koordinatorja e NJKDNJ-së, njëherit edhe Person kontaktues në projektin ROMACTED II në mes komunës dhe KE, në koordinim me kryetarin e komunës dhe Këshillin e Europës caktoi datën e përurimit të lokalit të Lulishtes në Kamenicë. Lulishja “Luludi” u përurua në Kamenicë si rezultat i një bashkëpunimi të suksesshëm mes Komunës së Kamenicës dhe Këshillit të Europës, në

kuadër të projektit ROMACTED II. Kjo iniciativë, e ideuar nga të rinjtë e komunitetit rom, synon të përmirësojë pamjen e qytetit, të promovojë integrimin dhe të fuqizojë zhvillimin ekonomik lokal, duke sjellë një vlerë të re për komunitetin (22 nëntor 2024)

- **Komuna e Kamenicës hap fushatën: “16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”** me një ecje simbolike, që përcolli mesazhin e solidaritetit dhe ndërgjegjësimit për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe në familje, organizuar nga Zyrtarja për Barazi Gjinore, bashkë me Koordinatorin e NIKDNI-së, dhe GJK. Organizatorët bënë thirrje për bashkëpunim të gjithë qytetarëve, duke theksuar rëndësinë e angazhimit për një shoqëri më të sigurt dhe të drejtë (25 nëntor 2024).

- **Mbahet tryeza e rrumbullakët: “Të bashkuar Kundër Dhunës”** - U mbajt tryeza e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje (MKKDDHF), nën moton “Të bashkuar Kundër Dhunës” dhe sloganin “Sot dhe çdo ditë tjetër”. Ky aktivitet u organizua nga Koordinatorja e MKKDDHF, në bashkëpunim me Zyrtaren për Barazi Gjinore, Grupin e Grave të Kamenicës (GJK) dhe organizatën SOLIDAR Suisse. Në mbledhje morën pjesë Zv. Avokati i Popullit, z. Basi Kastri, si dhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave lokale, përfshirë Strehimoren “Liria” Gjilan, DSHMS, Prokurorinë, Policinë e Kosovës - Stacioni Policor Kamenicë, QPS, Bashkësinë Islame, Zyrën e Punësimit, Grupin e Grave, OJQ Handikos, Zyrën për Ndihmë Juridike Falas dhe OSBE-në. Pjesëmarrësit diskutuan dhe raportuan mbi përvojat dhe sfidat në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, duke ofruar informacione mbi përgjegjësitë dhe qasjen e secilit institucion (2 dhjetor 2024)

- **3 Dhjetori – Dita Ndërkombëtare e Personave me Afësi të Kufizuara** - HANDIKOS, në bashkëpunim me Njësinë Komunale për të Drejtat e Njeriut në Kamenicë, organizoi një tryezë diskutimi me moton: “SOT ËSHTË DITA JOTE – NGRITJE ZËRRINJ”. Qëllimi ishte ndërgjegjësimi mbi të drejtat dhe përfitshinjen e personave me afësi të kufizuara në çdo aspekt të jetës. Në këtë ngjarje përpos anëtarëve të HandIKOS-it morën pjesë edhe Drejtori i Arsimit, Drejtoreshat: e Administratës, Buxhetit e Financave, Kadastrit, Pronës dhe Gjeodezisë, Zyrtarja për Barazi Gjinore, Zyrtar nga DSHMS, psikologë dhe asistentë. Tryeza u shoqërua me diskutime dhe kërkesa për përmirësimin e qasjes në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie. Aktiviteti përfshiu shpërndarjen e fletëpalosjeve sensibilizuese, një video ndërgjegjësuese dhe performanca të nxënësve nga SHFPMU “Skënderbeu” (3 dhjetor 2024).

- Në kuadër të Fushatës 16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës me Bazë Gjinore është organizuar takimi “Ndërtimi i një qasjeje të ndjeshme gjinore në identifikimin, referimin dhe trajtimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”. Në këtë takim të pranishëm ishin Drejtoresha Ekzekutive e QKRMT-së, Dr.Feride Rushiti, Koordinatorja e NIKDNUJ-së, Menaxherja e Projektit Florida Gashi, Nebahate Zeka Psikologe në këtë qendër, Drejtoresha të Drejtorive Komunale, përfaqësues të Qendrës për Punë Sociale në Kamenicë, zyrtarë komunal, përfaqësues të OJQ-ve, dhe të tjerë. Nga të gjithë pjesëmarrësit u diskutuan sfidat se si t'i bëjnë të lehtë dhe t'i identifikojnë këto viktime, e poashtu edhe si t'iu ofrohet ndihmë (4 dhjetor 2024).

- U mbajt punëtorja sensibilizuese me temën “Dhuna në familje me të rinjtë e komunitetit Rom”, e organizuar në kuadër të fushatës globale 16 Ditë të Aktivizmit Kundër Dhunës ndaj Grave. Aktiviteti u realizua nga OJQ “Luliu” në bashkëpunim me NIKDNUJ dhe me mbështetjen e OSBE-së ku morën pjesë rreth 50 të rinj të komunitetit rom të cilët morën njohuri rreth parandalimit të Dhunës me Bazë Gjinore. Ky aktivitet nënvizoi përkushtimin e institucioneve dhe organizatave vendore për të mbrojtur të drejtat e grave dhe burrave dhe për të promovuar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë në Kamenicë (5 dhjetor 2024).

Takimi i parë për Hartimin e Planit të Veprimit të Ekspertëve të Drejtat e Fëmijëve -

U mbajt takimi i parë i Hartimit të Planit të Veprimit të Ekspertëve të Drejtat e Fëmijës, organizuar nga Koordinatorja e NIKDNUJ-së, Nazmije Demolli Kasrati me mbështetje të Koordinatorit të Projektit Naser Lajqi nga OJQ “Syri i Vizionit”, Ejup Kamberaj - Shef i DADNUJ pranë MAPL-së, Luljeta Ibishi Ferizi - Zyrtare e Lartë në DADNUJ pranë MAPL-së dhe Qendresa Ibra Zarifi - Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Fëmijëve pranë Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit. Ky aktivitet kishte për qëllim mbështetjen e ekspertëve të drejtat e fëmijëve në nivel komune për përpilimin e një plani gjithëpërfshirës dhe funksional, që adreson nevojat dhe të drejtat e fëmijëve. Pjesëmarrësit u angazhuan në një diskutim të frytshëm rreth prioritetëve që duhet të përfshihen në plan, duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara nga mbështetja e OJQ-së “Syri i Vizionit” (6 dhjetor 2024).

PJESËMARRJE NË TAKIME, TRYEZA DISKUTIMESH E PROGRAME TË NDRRYSHME

- **Seminari: “Politikat për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë - Me ftesë të Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, Koordinatorja e NJKDNJ-së, Nazmiqe Demolli Kastriati, mori pjesë në seminarin e përbashkët me temën “Politikat për avancimin e të drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë”.**

Seminari bashkoi zyrtarët e institucioneve të Kosovës dhe shoqërinë civile, të cilët punojnë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Aty u vlerësua gjendja aktuale dhe priorizimi i aktiviteteve në pesë sektorët prioritarë: Arsimi, Punësimi dhe Mirëqenie Sociale, Shëndetësia, Banimi dhe Diskriminimi, dhe angazhimet e politikave për avancimin e të drejtave të këtyre komuniteteve (5 qershor 2024)

Parandalimi i martesave të hershme në Kosovë - Me ftesë të Zyrës së Kryeministrit, Koordinatorja e NJKDNJ-së, Nazmiqe Demolli Kastriati mori pjesë në takim. Parandalimi i martesave të hershme në Kosovë. Në këtë takim morën pjesë Kryeministri i Republikës së Kosovës Albin Kurti, Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, Drejtori i ZQM/ZQM, Habit Hajredini, përfaqësues nga institucionet e të dy niveleve lokale dhe qendrore për të diskutuar rreth raportimit dhe parandalimit të martesave të hershme tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (7 qershor 2024)

Punëtorja për mësim dhe shkëmbim ndërmjet institucioneve të angazhuara në zbatimin e kartës evropiane për barazi të grave dhe burrave. Me ftesë të UN Women në bashkëpunim me MAPL dhe ABGJ Koordinatorja e NJKDNJ-së, mori pjesë në punëtorinë për mësim dhe shkëmbim ndërmjet institucioneve të angazhuara në zbatimin e kartës evropiane për barazi të grave dhe burrave (19-21 qershor 2024)

Trajnimi: “Zhvillimi i lidershipit, zhvillimi i aftësive të komunikimit për një lidership efektiv” Me ftesë të Qendrës së Trajnimit e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) në kuadër të aktiviteteve të saj, Koordinatorja e NJKDNJ-së, përfaqësueset e Grupit të Grave të Kamenicës si dhe anëtarët e Grupit të Grave të Regjionit të Gjilanit, morën pjesë në trajnimin “Zhvillimi i lidershipit, zhvillimi i aftësive të komunikimit për një lidership efektiv”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrset ta kuptojnë zhvillimi i lidershipit, zhvillimin e aftësive të komunikimit për një lidership efektiv (25 qershor 2024)

25 vjetori i OSBE-së në Kosovë - Me ftesë speciale Koordinatorja e NIKDNI-së mori pjesë në shënimin e 25 vjetorit të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Kjo ngjarje mbledhi krerët të rëndësisshmëm shtetëror, zyrtar publik e OJQ bashkëpunor të ngushtë të OSBE-së. Pjesëmarrësit falenderuan kontributin e OSBE-së (25 qershor 2024)

Puntoria për zhvillimin e planeve të veprimit për rimëkëmbjen socio-ekonomike pas Covid - Koordinatorja e NIKDNI-së, bashkë me Hysen Jerliu - Shef në Drejtorinë e Shërbimeve Publike si dhe Dejan Blagojeviq-Shef i ZKK, morën pjesë në Puntorinë për zhvillimin e planeve të veprimit për rimëkëmbjen socio-ekonomike pas Covid. Në vazhdim të tryezës, nevoja për hartimin e planeve të veprimit në nivel lokal ishte një nga rekomandimet kryesore nga kjo puntori (5 korrik 2024).

Sesioni informues për prezantimin e Kornizës Monitoruese zv/kryesues dhe sekretar/e të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës - Me ftesë të MAPL-së në koordinim me ZQM/ZKM dhe në bashkëpunim me organizatat 'Syri i Vizionit' dhe 'Save the Children Kosova/o, Koordinatorja e NIKDNI-së, bashkë me Drejtoreshën e DSHMS-së, dhe Përgjegjësen e Sektorit të Shëndetësisë, morën pjesë në sesionin informues për prezantimin e Kornizës Monitoruese në zbatimin e Planeve të Punës së Ekipave për të Drejtat e Fëmijës. Qëllimi i këtij sesi informues me zv/kryesues dhe sekretar/e e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës nga komunat Mitrovicë, Vushtrri, Rahovec, Drenas, Fushë Kosovë, Hani i Elezit, Shterpcë, Kamenicë, Shtime dhe Ferizaj, ishte ngritja e kapaciteteve të tyre dhe familjarizimi më kornizës monitoruese që raportimet mbi punën e tyre të jenë sa më cilësore (10 korrik 2024)

Takimin për Moderimin e Dialogut Publik - Me ftesë të Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë Koordinatorja e NIKDNI-së mori pjesë në Takimin për Moderimin e Dialogut Publik. Qëllimi i takimit ishte që pjesëmarrësit të angazhohen në ushtrime

praktike të fokusuara në aspekte të ndryshme të lehtësimit të dialogut publik, të tilla si krijimi i pyetjeve hapëse dhe vendosja e bazave për përgatitjen dhe modernimin e dialogut publik efektiv (25 korrik 2024)

Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas –Me ftesë të ZQM/ZKM, Koordinatorja e NIKDNI-së, së bashku me Zyrtaren për Barazi Gjimore morën pjesë në sesion informues i cili u fokusua në mekanizmat raportues të diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përkatësisht Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet në fjalë, mbështetur nga Organizata Terre des Hommes (9 shtator 2024).

Lansimi i Qendrës Rajonale për Gratë, Paqen dhe Sigurinë - Me ftesë të Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, Dr Vjosa Osmani Sadriu, Koordinatorja e NIKDNI-së, Nazmije Demolli-Kastrati, mori pjesë në lansimin e Qendrës Rajonale të Ekselencës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (ËPPS). Kjo qendër do të kontribuoi në avancimin e Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, një iniciativë e Zyrës së Presidentes së Kosovës, duke vepruar si në nivel lokal ashtu edhe rajonal. Qendra adreson sfidat e rënda me të cilat përballen gratë dhe vajzat në zonat e konfliktit dhe luftës, duke ofruar një kuptim më të thelluar mbi rëndësinë e rolit të grave në proceset e paqes dhe sigurisë, si dhe fuqizimin e tyre si lidere (17 shtator 2024)

Debati: “Parandalimi i dhunës dhe dukurive negative në shkollat e Komunës së Kamenicës - Me ftesë të OJQ Dardana Press, Koordinatorja e NIKDNI-së, Nazmije Demolli Kastrati, dhe Zyrtarja për Barazi Gjimore, Kosovare Maroca Berisha, morën pjesë në debatin mbi parandalimin e dhunës dhe dukurive negative në shkollat e Komunës së Kamenicës. Folsja e këtij debati Koordinatorja e NIKDNI-së, Nazmije Demolli Kastrati theksoi nevojën për ligjërata të vazhdueshme dhe diskutime interaktive për ndërgjegjësimin e nxënësve dhe parandalimin e sjelljeve të dëmshme, duke i ndihmuar ata të kuptojnë pasojat dhe të zhvillojnë sjellje pozitive që në moshë të re. Ajo gjithashtu informoi të pranishmit mbi rolin e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje (24 shtator 2024)

Tryeza e diskutimit mbi themelimin e Tryezave Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve në komunat e rajonit të Gjilanit. Me ftesë të organizatës Terre des hommes, Koordinatorja e Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut (NIKDNI) Zyrtarja për Barazi Gjimore, morën pjesë në tryezën e diskutimit mbi themelimin e Tryezave Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve nëpër komuna. Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi i procesit të themelimit të Tryezave Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rasteve (TNMR), sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Rregullores (QRK) nr. 23/2023 për procedurat e punës në tryezat multidisiplinare (26 shtator 2024)

Tetori Rozë - Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit - Me rastin e fillimit të Tetorit, Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit, Koordinatorja e NIKDNI-së, dhe Zyrtarja për Barazi Gjimore morën pjesë në një aktivitet të organizuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale lidhur me ndërgjegjësimin e qytetarëve për kancerin e gjirit. Qëllimi i Fushatës ishte thirrja për të gjitha gratë:

Le të ngremë zërin së bashku për shëndetin e çdo gruaje! Kujdesi për veten nuk pret – bëje mamografi në sot! Në QKMF Kamenicë, ky shërbim ofrohet falas.

Kontrolli i hershëm mund të shpëtojë jetë. Gjithashu, Koordinatorja e NIKDNI-së, përgatiti një videospot të cilin e ka lansuar në faqen e NIKDNI-së me qëllim të vetdijësimit (17 tetor 2024)

Komuna e Kamenicës përfaqësohet në punëtorinë për parandalimin e ngacmimit seksual në institucionet publike - Me ftesë të ZQMJ/KKM, Koordinatorja e NIKDNI-së, Zyrtarja për Barazi Gjimore, morën pjesë në punëtorinë trajnuese të mbështetur nga OSBE. Tema e punëtorisë ishte:

“Parandalimi i ngacmimit seksual në institucionet e administratës publike”. Qëllimi kryesor i trajnimit ishte diskutimi mbi format e ndryshme të ngacmimit seksual në vendin e punës, përfshirë praktikat më të mira ndërkomëtare dhe kuptimi i legjislacionit të Kosovës që rregullon parandalimin dhe trajtimin e këtyre rasteve.

Takimi i Tryezës për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit(TNMR) - Koordinatorja e NIKDNI-së mori pjesë në takimin e Tryezës për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit(TNMR) Çështjet që u diskutuan ishin:

1. Funkcionalizimi i TNMR-së, themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës
2. Rasti i fëmijëve të përfshirë në sfidën e TIK TOK-ut (SHFMU “Abdulla Krashnica” Koretin)
3. Diskutime lidhur me gjendjen e përgjithshme të mbrojtjes së fëmijëve në Kamenicë
4. Të ndryshme (25 tetor 2024)

Takimi i parë i Grupit Punues për Hartimin e Rregullores komunale për Asamblenë komunale të Fëmijëve - Koordinatorja e NIKNI-së, njëherit edhe kresuese e Grupit punues për Hartimin e Rregullores komunale për Asamblenë Komunale të Fëmijëve bashkë me OIQ NOPM organizuan takimin e parë me grupin punues. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi dhe hartimi i draft rregullores komunale për Asamblenë e Fëmijëve duke konsultuar legjislacionin në fuqi (25 tetor 2024)

- **Politika e Mbrojtjes së Fëmijës -** Koordinatorja e NIKDNI-së, ka marrë pjesë në një takim në hapësirat e Qendrës Fanar, me ftesë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Kamenicës dhe mbështetur nga Fondacioni Terre des Hommes Kosovë. Takimi u mbajti për të prezantuar Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës për drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në këtë komunë.

Integrimit gjinor dhe vlerësimi i ndikimit gjinor - Koordinatorja e NIKDNI-së mori pjesë në trajnimin me temën "Integrimit gjinor dhe vlerësimi i ndikimit gjinor", i udhëhequr nga trajnerja e projektit GEF, Znj. Mirjeta Nagavci. Ky trajnim kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve të stafit komunal dhe palëve të tjera të përfshira për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj gjinisë në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve në nivel lokal.

Hapja e Fushatës Globale "16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore" në Nivel Qendror - Me ftesë të Ministrisë së Drejtësisë, Kryesuesja e Grupit të Grave të Kamenicës, Koordinatorja e NIKDNI-së dhe Zyrtarja për Barazi Gjinore, morën pjesë në ceremoninë madhështore të hapjes së fushatës globale "16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore". Kjo ngjarje, e cila bashkoi liderë politikë, përfaqësues institucionale, aktivistë dhe qytetarë, shënoi fillimin e një angazhimi të përbashkët për t'i dhënë fund dhunës që prek gratë dhe vajzat (25 nëntor 2024).

Samiti i Ballkanit Perëndimor Kundër Diskriminimit Racor - Koordinatorja e NIKDNI-së, e shoqëruar nga Zyrtarja për Barazi Gjinore, morën pjesë në Samitin e Ballkanit Perëndimor kundër Diskriminimit Racor, i cili u mbajt në Swiss Diamond Hotel në Prishtinë. Samiti mbledhi qeveritë, organizatat e shoqërisë civile, ekspertët e pavarur dhe komunitetet për të adresuar çështjen e diskriminimit racor, veçanërisht ndaj komuniteteve RAE në rajon (26 nëntor 2024).

Konferenca: "Të Bashkuar Kundër Dhunës – Mjafit!" - Me ftesë të Ministrisë së Drejtësisë, Koordinatorja e NIKDNI-së, e shoqëruar nga Zyrtarja për Barazi Gjinore morën pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme. Konferenca kishte për qëllim të ofronte një platformë gjithëpërfshirëse për diskutim me akterët relevantë për parandalimin, mbrojtjen dhe adresimin e dhunës në familje, dhunës ndaj gruas dhe dhunës me bazë gjinore. Ngjarja përfshiu një ceremoni hapjeje, panele diskutimi dhe një mundësi për tjetëzim ndërmjet aktorëve kryesorë që punojnë për integritimin dhe MD të komuniteteve (26 nëntor)

Takim Informues mbi Drejtësinë Tranzicionale - Koordinatorja e NIKDNJ-së, e shoqëruar nga Zyrtarja për Barazi Gjimore, kanë marrë pjesë në takimin Informues mbi Drejtësinë Tranzicionale, aktivitet përmbyllës i programit ROMACTED II për vitin 2024. Ky takim kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes në mesin e komunave dhe komuniteteve lokale për konceptin dhe parimet e drejtësisë tranzicionale, si dhe shkëmbimin e informacionit mbi mekanizmat ekzistues për ballafaqimin me të kaluarën (27 nëntor 2024)

Mbledhja e parë të Këshillit të Nxënësve në nivel komunal - Koordinatorja e Njësise Komunale për të Drejtat e Njeriut (NIKDNJ), mori pjesë në mbledhjen e parë të Këshillit të Nxënësve në nivel komunal e cila gjatë takimit foli për rëndësinë e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së nxënësve në fushatën “16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës me Bazë Gjimore”. Ajo theksoi nevojën për të informuar sa më shumë nxënës lidhur me parandalimin e dhunës dhe shpërndau materiale informuese në këtë drejtim. Mbledhja u organizua me qëllim përfaqësimitin e zërit të nxënësve dhe avancimit e të drejtave të tyre në nivel komunal, duke diskutuar çështje me rëndësi për mirëqenien dhe arsimin e tyre (2 dhjetor 2024).

ZYRTARI I LOGJISTIKËS

| | | |
|--|------------|--|
| Kërkesa për pëdorimin e Veturav Zyrtare | 274 | |
| Të Aprovuara | 268 | |
| Të Anuluara | 6 | |
| Të pa nënshkruara nga Autorizuesit | 0 | |

| | |
|------------------------|---|
| Te pa Approvuar nga un | 0 |
|------------------------|---|

Konsideroj se nga muaji qershor e deri më tani kanë qënë muaji të suksesit per Komunen tonë,ne kemi arritur disa objektiva dhe qellime te rendesishme për këta muaj,dhe kemi bërë progress të vazhdueshem ne te gjitha fushat dhe aktivitetet tona. Veturat i kemi ndarë në Drejtori mirpo kemi pak probleme sa i përket kërkessav dojnë ti marrin Veturat dhe mos të plotësojnë kërkesë dhe agjendë.ka dhe shum parregullsi ne kilometra sa i perket veturav të cilat po shfrytëzohen ,një detaj që duhet të ceket kemi pasë munges te fleturdhëresav për plotesimin e kilometraav në vetura Zytarre mirpo tash jemi në rregull sepse jemi furnizuar .një vetur kemi marrë të re,ka vozit Kryetari nje koh dhe pastaj I ka dhan Uran berishes dhe ai mban Qelesin e kesaj veture dhe as nuk ploteson kërkesë,përveq kësaj kjo vetur është Aksidentuar nga Rahim Osmani.

Veturen Toyota Prada me targa 06Z-16-10 ka Zimb dhe nuk dorezon qelesin dhe nuk ploteson Kërkesë.

ZYRTAR PËR PRANIM TË MALLIT

Gjate kesaj periudhe kemi bere pranimin e furnizimit të gjitha Drejtorive Komunale në Komunën e Kamenicës

- Kemi pas 45 furnizime gjat ketyre muajve nga furnitore te ndryshem.

- Kemi bere verifikime ne teren të mallit gjate pranimit te tij, duke i kontrolluar sasin, kualitetin dhe kemi shqyrtuar me kujdes kerkesat nga drejtorit Komunale.dhe kemi raste kur pranohen nga drejtorit dhe ne baze te Fatures dhe fletdergeses I bejm hyrje/dalje.
- Kam bere pranimin dhe protokolimin e te gjithave faturave, te telefonis,internetit,ujit dhe hijenes dhe gjithashu faturat të ndryshme,për të gjitha drejtorit komunale dhe I kemi dërgu në Drejtorin e Financa dhe Buxhet për procedura të matujeshme për pagesa. (gjithsej janë 1089)
- Të gjitha furnizimet dhe pranimin e mallrave dhe sherbimeve i kemi te rexhistruar ne programin E-Pasuria(167 dalje 25 *Transfere*) kopjen fizike,gjithashu për të gjitha lëndet te cilat i kemi pergaditur per pages. 327 raporte nga (SIMFK)-Free Balance për të cilin programë jam i certifikuar.
- Kam gene disa her anëtar i komisionit të hapjes së ofertave/aplikacioneve për procedurën e prokurimit dhe komision.
- **Jam pergjegjes per Rezervim te Salles se Kuvendit Komunal**
- Jam I Caktuar Nga Drejtoria e Adminstrates se Pergjithshme te bej barazimet e te hyrave ne D.A.P
- *Jam I caktuar Vendim të Kryetarit.zyrtar për gjegjës për kursimin e Energjisë.*
- Kam bashkpunuar dhe kemi ndimuar ne programin **epasuria** me sektor të tjerave drejtorive,për kërkesat dhe problemet e tyre
- Jam I Caktuar me Vendim te Kryetarit 4 Komisione anëtar I komisionit.

ZYRTARE ADMINISTRATIVE PËR PUNË TË KUVENDIT

Raporti i punes per periudhen Qershor – Nentor 2024

- Gjate kësaj periudhe kam përcjellë mbledhjet e Kuvendit, mbledhjet e Komitetit për Komunitete dhe Komitetit për Politikë e Financa,
- Kam përgatitur procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit, mbledhjeve të jashtëzakonshme, mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe të Komitetit për Komunitete,
- Përgatis materialin e Komitetit për Komunitete dhe i njoftoj anëtarët e këtij komiteti për mbledhje,
- Kam ndihmuar në punët që më kërkohen nga kryesuesi ose asistentja e tij.

Recepzioni

| Nr. | Totali i vizitave dhe kërkesave për takim me zyrën e Kryetarit dhe drejtoritë e ndryshme |
|-----|--|
| 1 | 433 |

Drejtoria Komunale e Arsimit:

| muaji | projekti | vlera |
|--------|---|---------|
| | Furnizimi i shkollave me perde | 19206.5 |
| | Vizite 2 javore e nxenesve te IAAP ne Turqi | |
| | Vizite 3 ditore e nxenesve ne Rome | |
| | Furnizimi i shkollave me materiale didaktike | 41515.7 |
| Korrik | Testimi i nxenesve ne fund te klases se V-te (shkalla 2) | |
| | Ndajta solemne e deftesave per nxenes ne perfundim te shkollimit te mesem te ulte | |
| | Pajisja e HEA me mjete didaktike te muzikes | |
| | Furnizimi i te gjitha HEA me Kompjuter | |
| | Certifikimi i mesindhemesve per projektin e vleresimit te mbrendeshem te shkolles | |
| gusht | Renovimi i SHFMU ""Asllan Thaqi" Karageve e Poshtme | |
| | Renovimi i SHFMU "Rexhep Mala" Topanice | |
| | Furnizimi i Kabineteve Profesionale ne IAAP | 51000 |

| | | |
|---------|---|-------|
| | Sigurimi i transportit per nxenes | |
| Shtator | Pajisja e nxenesve me llaptop personal | |
| | Furnizimi i SHFMU me mjete per kabinete te muzikes | |
| | Pajisja e shkolleve me robot dhe filmi i implementimit te KODIMIT ne shkola | |
| | Furnizimi i IEA me mjete te Artit Figurativ | |
| | | |
| | Konkursi per shkolllen MODEL | |
| Tetor | Pajisja e dy shkolleve me Ipad | |
| | Mikëpritje e delegacionit te arsimit nga Komuna Mustafakemalpasha | |
| | Mbatja e trajnimeve per implementimin e Politikave për Mbrojtjen e fëmijës | |
| | Mbatja e Olimpiades se Matematikes | |
| | | |
| Nentor | Furnizimi me energji elektrike i SHMF ""Mehush Krasniqi" Rogane | 36800 |
| | Java e "Gjuhës Shqipe" | |
| | Java e "Pavaresise" | |
| | | |

| | | |
|---------|--|-------|
| | Kontraktimi i Projektit te uniformave per nxenes ne SHML | |
| | Ndarja e Bursave per studente | 46700 |
| | Subvencionimi i nxenesve ne IAAP | 10100 |
| | Inventarizimi i asetave ne IEA | |
| | Shpeblimi i nxenesve te suksesshem dhe mesimdhenesve | 9710 |
| Dhjetor | Ofrimi i sigurimeve shendetesore te femijeve ne cerdhe | |
| | Ofrimi i sigurimeve aksidentale per nxenesit ne IAAP | |
| | | |

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:

| AKTIVITETET I PARAPARË | REZULTATET E ARRITURA | KOHAT E FILLIMIT | A ËSHITË MBYLLUR AKTIVITETI? | PERSONI/AT PËRÇJEGJËS | MBËSHPRETTJA E NEVOJITUR |
|--|--|-----------------------|------------------------------|---|-----------------------------------|
| <p>Mbikëqyrja e punës së Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe bashkëpunimi me njësimë</p> | <p>- Takime të rregullta pune me menaxhmentin e QKMF-së dhe akterët e tjerë relevantë në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase në kujdesin parësor-shëndetësor për të gjithë qytetarët e Komunës së Kamenicës pa dallim, përkatësisht, realizimit të detyrave dhe objektivave të DShMS-së;</p> <p>- Përfundimi i projektit të asgjësimit të barërave me afat të skaduar;</p> <p>- Përfundimi i rtrënimit të objektit në oborrin e QKMF-së;</p> | <p>Korrik-Dhjetor</p> | <p>/</p> | <p>1. Greta Kryeziu 2. Dr. Latif Sylaj 3. Këshilli Drejtues i QKMF-së</p> | <p>Bashkëpunimi ndër-kolegial</p> |

| | | | | | |
|--|---|-----------------------|----------|---|---------------------------------------|
| | <p>- Ofirmi i zgjidhjes së përkohshme për zyrën e OJQ HandiKOS në objektin e QKMF-së;</p> <p>- Përgatitja dhe lansimi i videos ilustrative rreth informimit të qytetarëve për për zgjedhjen e mjekut familjar nëpërmjet sistemit elektronik e-Kosova;</p> | | | | |
| <p>Mbikëqyrja e Qendrës për Punë Sociale dhe bashkëpunimi me njësinë</p> | <p>- Takime të rregullta pune me Drejtorin e QPS-së, Udhëheqësen e Shërbimeve Sociale dhe Udhëheqësin e Asistencës Sociale, në më qëllim të ofrimit të shërbimeve efektive sociale, familjare dhe të asistencës sociale, në funksion të mirëqenies së qytetarëve të Komunitetit të Kamericës, trijehimisht realizimit të deyrave dhe objektivave të DShMS-së.</p> | <p>Korrik-Dhjetor</p> | <p>/</p> | <p>1. Greta Kryeziu 2. Rifat Hajdari</p> | <p>Bashkëpunimi ndër-kolegial</p> |
| <p>Mbikëqyrja e Shërbisë së Komunitetit në</p> | <p>- Takime të rregullta pune me Udhëheqësin e SHKK-së, në funksion të</p> | <p>Korrik-Dhjetor</p> | <p>/</p> | <p>1. Greta Kryeziu 2. Hajdin Krivaga</p> | <p>Bashkëpunim ndër-institucional</p> |

| | | | | | |
|---|---|----------------|---|------------------|--|
| Kamenicë dhe bashkëpunimi me njësinë | <p>ofimit të shërbimeve efikase rezidenciale, për personat me aftësi të kufizuar mendore – ngecje në zhvillim mendor, sipas kërkesave të parashtruara nga organet përkatëse.</p> <p>- Shqyrtimi dhe vendosja në Kërkesat e parashtruara për vazhdimin e qëndrimit të klientëve-rezidentëve në SHKK.</p> | | | | Bashkëpunimi me Kryetarin e Komunës, |
| Bashkëpunimi me Zyren e Kryetarit, Kuvendin Komunal dhe Drejtoritë e tjera në kuadër të komunës | <p>-Takime pune me Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, Shefin e Kabinetit, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Bordin e Drejtorëve etj;</p> <p>-Pjesëmarrje në seancat e Kuvendit Komunal;</p> <p>-Applikimi në projektin për Banim Social dhe të Përballueshëm;</p> | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu | Bashkëpunimi me Kryetarin e Komunës, MMPHI, si dhe akterët e tjerë relevantë |

| | | | | | |
|--|--|----------------|---|---|--|
| | -Konfirmimi i Shprehjes së interesit për aplikim në programin për Banim Social dhe Adekuat; | | | | |
| Informata dhe sqarime për Aplikim për Ndihmë financiare | -Ofrimi i informatave për palë dhe asistencës për aplikim për ndihmë financiare, e cila ndahet nga Komisioni për ndarjen e subvencioneve nga lëmi i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, i cili vepron pranë ZKA-së. | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu 2. Staffi i DShMS-së | Bashkëpunimi me stafin e DShMS-së |
| Planifikimi i rregullt i buxhetit për rjesitë shpenzuese të DSHMS- | -Përgatitja e prioriteteve për buxhejin e DShMS-së 2023-2025. | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu | Bashkëpunimi me zyrtarët financiar të DShMS-së |
| Investime kapitale | - Ndërtimi i Ambulantës së Mjekësisë Familjare në fshatin Shipashticë të Epërme; - Ndërtimi i Kuzhinës Popullore | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu 2. Donatori Ahmet ul KUËARI - Kuvajti | Bashkëpunim me stafin e DShMS-së, Zyrtën e Kryetarit dhe Donatorët |

| | | | | | |
|---|--|----------------|---|------------------------------------|--|
| | | | | 3. Shoqata “Jehimat e Ballkanit” | |
| Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh), AQH-në | Implementimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2024 – Bashkë Pagesat për Shërbimet Shëndetësore, si dhe informimi i Administratës së QKMF-së për Udhëzimin në fjalë; - Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Kamenicës/Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe Shoqatës për të Drejtat e Pacientëve në Kosovë (PRAK), si dhe implementimi i detyrave dhe përgjegjësisve të cilat dalin nga ky Memorandum. | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu 2. Latif Sylaj | Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional |
| Bashkëpunim me Ministrinë e | -Koordnimi dhe bashkëpunimi i rregullt i njësisve të DShMS-së me MFPPT-në. | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu | Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional |

| | | | | | |
|--|--|----------------|---|---|--|
| Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) | - Mbikëqyrje e implementimit të pilotimit të skemës sociale sipas ligjit të ri, përmes sistemit elektronik e-Kosova. | | | | |
| Angazhimi i profesionistëve shëndetësor – Mjekëve Specialistë të fushave të ndryshme | - Angazhimi i Radiologut | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu 2. Latif Sylaj 3. Zyra e Kryetarit 4. Zyra e Personelit | Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional |
| Shërbimet DDD në Komunën e Kamenicës | - Realizimi i shërbimeve të DDD-së në Komunën e Kamenicës | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu 2. Menaxheri i Kontratës | Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional |
| Cilësia e Ujit të pijshëm | - Në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Gjilan është bërë testimi i mostrave të ujit në të gjitha shkollat e Komunës së Kamenicës. | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu 2. Afrim Dërvishi 3. Qendra Rajonale e Shëndetit Publik-Gjilan | Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional |

| | | | | | |
|--|---|----------------|---|------------------|--|
| Organizimi i kompanjave/fushatave senzibilizuese | <ul style="list-style-type: none"> - Fushatë senzibilizuese “Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit” ligjeratë nga Dr. Muharrem Sadiku; - Shpërndarja e broshurave dhe informatave nga personeli shëndetësor në të gjitha institucionet e kujdesit Parësor Shëndetësor në Komunën e Kamenicës dhe në sheshin e qytetit; - Takime informuese dhe ligjerata senzibilizuese për sëmundjen e kancerit të gjirit. - Marsh në Sheshin e qytetit me moton “Zbulimi i hershëm-Mbijetesë”. - Shënimi i “Ditës botërore të Diabetit”; - Shënimi i “Ditës botërore të Zenres”; - Karnavani shëndetësor për përmisimin e shëndetit dhe vetëdijesimin e qytetarëve për sëmundjet jo-ngjitëse në bashkëpunim me organizatën Syri i Vizionit. - Shënimi i “Ditës nderkombetare të | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu | Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional |
|--|---|----------------|---|------------------|--|

| | | | | | |
|---|---|----------------|---|---|----------------------------------|
| | infernierëve"; - Shënimi i 1-Tetorit, Ditës Ndërkombëtare të të moshuarve"; - Ndërgjegjësimi për përdorimin e antibiotikëve në Kujdesin Primar Shëndetësor. | | | | |
| Realizimi i kontrollave sistematike për nxënës në shkollat e Komunës së Kamenicës | -E kemi hartuar Projektin e kontrollave sistematike për nxënësit, në shkollat fillore të Komunës së Kamenicës, Nr.44/2024 të datës 03.12.2024, si dhe orari i realizimit të kontrollave dhe jemi në prag të fillimit të këtij projekti | Korrik-Dhjetor | | 1. Greta Kryeziu 2. Latif Sylaj 3. Afrim Dërvishi | Bashkëpunim ndër-kolegial |
| Ushtrimi i kompetencave dhe përgjegjësiive të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të | Në koordinim me stafin e DShMS-së, në mënyrë kontinuele i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në kuadrin e kompetencave tona, në funksion të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësiive në realizimin e misionit dhe objektivave të | Korrik-Dhjetor | / | 1. Greta Kryeziu | Bashkëpunim me stafin e DShMS-së |

| | | | | | |
|--------------------------------|---|--|--|--|--|
| deleguara nga pushteti qendror | <p>Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.</p> <p>Hartimi i aketeve juridike të cilat dalin nga fushëveprimtaria e drejtorisë në bazë të procedurave të përcaktuara dhe sipas legjislacionit në fuqi, e të cilat janë si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikimi i stafit; 2. Hartime i vendimeve; 3. Shqyrtimi i kërkesave; 4. Formimi i Komisioneve; 5. Inicimi i procedurave të ndryshme; 6. Administrimi dhe përpunimi i lëndëve për pranimin e donacioneve; 7. Hartimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit; 8. Implementimi i Rekomandimeve nga Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorës Kombëtare kundër Dhunës | | | | |
|--------------------------------|---|--|--|--|--|


| | | | | | |
|--------------------------|---|-----------------------|-----------|------------------------|--|
| | <p>në familje, e cila i është drejtuar Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës;</p> <p>8. Krijimi i Databazës së të dhënave nga Kontrollat sistematike të vitit të kaluar dhe përditësimi me të dhënat të cilat do të administrojnë nga ky projekt;</p> | | | | |
| <p>Aktivite të tjera</p> | <p>- Takim me përfaqësuesit e Kujdesit Parësor Shëndetësor të 20 Komunave primare, AQH Projekt;</p> <p>-Takim me organizatën zvicerane “CARITAS” me qëllim të shqyrtimit të mundësisë së bashkëpunimit me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;</p> <p>-Takim me organizatën daneze “Danish Refugee Council” DRC, me qëllim të bashkëpunimit për sigurimin e disa</p> | <p>Korrik-Dhjetor</p> | <p>Po</p> | <p>I.Greta Kryeziu</p> | <p>Bashkëpunimi ndër-institucional</p> |

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | <p>pakove ushqimore dhe higjienike për shfrytëzuesit e asistencës sociale.</p> <p>-Pjesëmarrje në trajnime të tjera, punëtori dhe tryeza diskutimi me qëllim të ngritjes profesionale.</p> <p>- Përgatitja dhe realizimi i aktivitetit “Dhurimi i gjakut” në bashkëpunim me Transfuzionin e Gjakut;</p> <p>-Pjesëmarrje në punëtoritë e organizuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht, Departamenti për kthim dhe ri-integrim;</p> | | | | |
|--|--|--|--|--|--|

DREJTORIA E SHËNDËTËSISË DHE MIRTËQENIES SOCIALE - KAMENICË (DSHMS)

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-Kamenicë "Dr. Shaban Geci"

(QKMF)



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
 GLAVNI CENTAR PORODICNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE
 "Dr. Shaban Geci" KAMENICË

QKMF-KAMENICË Raport Statistikor i kontrollave shërb.shëndetsore për Vihën-2024

| Nr. | Lloji i shërbimit e kontrollimit mjekësor | Mjekësia familjare | Urgjencia | Shërb. shëndet. Pediat. | Punktet shëndet. sore | Vizitat shëpiak 0-3vjet | Shërb. Stomat. | Shërb. e Vaksin. | Mamografi | Gjinekolo gjia | Urologu | Shërb. R.T.G | Shërb. Labor. | Klasa për nëna | Totali |
|-----|---|--------------------|--------------|-------------------------|-----------------------|-------------------------|----------------|------------------|-------------|----------------|-------------|--------------|---------------|----------------|---------------|
| 1 | Shërbimet mjekësore | 35106 | 14694 | 7107 | 28910 | | 2737 | 4066 | 3814 | 962 | 2715 | | | | 100111 |
| 2 | Vizita mjekësore | 37451 | 56110 | 4094 | 29781 | 1257 | 12596 | 13715 | 5821 | 962 | 2715 | 4929 | 93162 | 385 | 262978 |
| 3 | Shërbimet shëpiake | | 1202 | | 206 | | | | | | | | | | 1408 |
| 4 | Shërbimet shëpiake | 615 | 4218 | | 1694 | | | | | | | | | | 6527 |
| | Total | 73172 | 76224 | 11201 | 60591 | 1257 | 15333 | 17781 | 9636 | 1924 | 5430 | 4929 | 93162 | 385 | 371024 |

Të ref. leshu QKMF
 Të trajtuar sorb
 Të trajtuar rom
 Të huaj

5131
1366
538
5

Kordinatoeja
 Selvete Isufi
 Kryeinfërmerja
 BSc. Natije Alvazi

Drejtori i QKMF-së
 Dr. Latif Sytej

RAPORT STATISTIKOR I SHËRBIMEVË SHËNDETËSORE TË QKMF-së, QMF, AMF-së VJETORI-2024

| Llojet e shërbimeve | M.Familja | Urgjencë | Pediatria | Punktet Shëndetësore | Vaksinat | V.Shërbime gjinekologjike | Mamografi | Gjinekologji | Urologji | Lab- Kamenet | Lab-Rd | Lab-Hod | RTG Kabineti | S.Kam | RTG- Stom | S.Rrogj | S.Hod | Klasa II | Ekipeve | Totali |
|---------------------|-----------|----------|-----------|----------------------|----------|---------------------------|-----------|--------------|----------|--------------|--------|---------|--------------|-------|-----------|---------|-------|----------|---------|--------|
| 1. Impleksione | 35105 | 14694 | 7107 | 28910 | 4066 | | 3832 | 962 | 2715 | | | | | 2238 | | 267 | 232 | | | 100128 |
| 2. Medicinale | 35105 | 56110 | 4011 | 29781 | 13582 | 1257 | 5890 | 962 | 2715 | 72737 | 47524 | 3901 | 4929 | 9443 | 808 | 1221 | 1204 | 385 | | 291565 |
| V. Shërbime | | 456 | | 206 | | | | | | | | | | | | | | | 746 | 1408 |
| 6. S.H. Shërbime | | 1279 | | 1694 | | | | | | | | | | | | | | | 2940 | 5913 |
| Totali: | 70210 | 72539 | 11118 | 60591 | 17648 | 1257 | 9722 | 1924 | 5430 | 72737 | 47524 | 3901 | 4929 | 11681 | 808 | 1488 | 1436 | 385 | 3686 | 399014 |
| Llojet e shërbimeve | Rogana | Hogoshi | Karagjevi | Koreta | Topani | Sh. e I. Destrivoi | Murgjave | Strezovi | Koperni | Krilevi | Tudhe | Busava | Lisoc | Polli | | | | | | Totali |
| Kontrollim | 25923 | 2887 | | | | | | | | | | | | | | | | | | 28910 |
| 1. Shërbime | 23914 | 5214 | 67 | 404 | | 192 | | | | | | | | | | | | | | 29791 |
| Vizitat | 199 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | | | | 206 |
| 3. Shërbime | 1608 | 86 | | | | | | | | | | | | | | | | | | 1694 |
| 4. Shërbime | 51644 | 8294 | 67 | 404 | 0 | 192 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 60601 |
| Nr. familjare | 894 | 63 | 291 | 131 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1. Shërbime | 253 | 78 | 160 | 47 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2. Shërbime | 5 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 3. Shërbime | 3169 | 384 | 1548 | 30 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 4. Shërbime | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

Raporti mbi vizitat sipas departamenteve-sherbimeve per periudhen Vjetore-2024

Institucioni Shenderesor:
Vendi-Kamernicë

| Departamenti (SHE RBIM 1) | Vizitat | | | | | | | | | | | | | | | | Numri i fijeve shendete | Mjeku | Vizita Shëndiaktive (në ditë) |
|---------------------------|--------------|---------|---------|------|------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|---------------|--------|--------|------|-------------------------|-------|-------------------------------|
| | Ne ordinancë | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Mjeku | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Githsej | Githsej | < 1 vje | 1-5 | 6-9 | 10-14 | 15-19 | 20-24 | 25-34 | 35-44 | 45-54 | 55-64 | 65+ vjeçanish | | | | | | |
| Mjekësia Fami | 86201 | 704 | 1992 | 2456 | 3498 | 5163 | 6346 | 8356 | 9655 | 12079 | 15472 | 20480 | | 150200 | 1406 | 6527 | | | |
| Pediatria | 7107 | 1170 | 1540 | 1625 | 1554 | 1218 | | | | | | | | 4094 | | | | | |
| Vaksinimi | 4066 | 625 | 481 | 621 | 326 | 534 | 81 | 295 | 221 | 81 | 242 | 759 | | 13715 | | | | | |
| Laboratori | 0 | | | | | | | | | | | | | 93162 | | | | | |
| | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 0 | 97374 | 2499 | 4013 | 4702 | 5378 | 6715 | 6427 | 8651 | 9876 | 12160 | 15714 | 21239 | 0 | 261171 | 1406 | 6527 | | |

SEKTORI I SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë periudhës raportuese (01.07.2024 - 06.12.2024) në sektorin e Shërbimeve Sociale janë pranuar gjithsej treqind e gjashtëmbëdhjetë (316) kërkesa të reja, nga individ dhe institucione, e të cilëve u janë ofruar shërbime profesionale nga ana e zyrtarëve të shërbimit social. Po ashtu përveç rasteve të reja të paraqitura, për shkak të natyrës së punës sociale, në shërbim kemi punuar edhe me raste të vjetra të bartura nga periudha e kaluar, por edhe nga vitet tjera paraprake.

Më poshtë do të parqesim në mënyrë tabelore të gjitha rastet e reja të paraqitura sipas kategorive:

Tabela nr.1.

| <i>Nr.ren</i> | <i>Kategoria e klientëve</i> | <i>Numri i rasteve të reja</i> |
|----------------------|--|---------------------------------------|
| <i>1</i> | <i>Fëmijë pa përkujdesje prindërore</i> | <i>0</i> |
| <i>2</i> | <i>Të mirrit në konflikt me ligjin</i> | <i>10</i> |
| <i>3</i> | <i>Fëmijët me sjellje asociale</i> | <i>17</i> |
| <i>4</i> | <i>Fëmijët me afësi të kufizuara</i> | <i>6</i> |
| <i>5</i> | <i>Fëmijët e keqtrajtuar</i> | <i>6</i> |

| | | |
|----|---|-----|
| 6 | <i>Fëmijë në situatë rruge</i> | 1 |
| 7 | <i>Të mirurit që kërkojnë të hyjnë në martesë</i> | 1 |
| 8 | <i>Çrregullime të marrëdhënieve bashkëshortore</i> | 9 |
| 9 | <i>Rastet e dhunës në familje</i> | 12 |
| 10 | <i>Kërkesa për kontakte familje-prind</i> | 2 |
| 11 | <i>Kërkesa për lëshimin e vërtetime f.sh</i> | 52 |
| 12 | <i>Kërkesa për vërtetim për lënjen e shtetësisë</i> | 5 |
| 13 | <i>Kërkesa për vërtetime për zotësi veprimi</i> | 184 |

| | | |
|----|---|------------|
| 14 | <i>Konstatime Zyrtare</i> | 2 |
| 15 | <i>Pelqim për udhëtim jashtë vendit</i> | 2 |
| 16 | <i>Personat me aftësi të kufizuara (mendore dhe fizike)</i> | 2 |
| 17 | <i>Të tjerë</i> | 5 |
| 18 | Total | 316 |

Komente: Në krahasim me periudhën e kaluar (gjysma e parë e vitit) kemi ngritje të konsiderueshme të numrit të kërkuesave (mëth 100 më shumë), ku numri më i madh i rasteve ka qenë nga kategoria administrative, vërtetimet.

Përveç rasteve të reja, nga shërbimi janë trajtuar edhe rastet e bartura nga vitet paraprake nga të gjitha kategoritë ku në përgjithësi janë kryer këto shërbime:

- **Fëmijët pa kujdes prindëror.** Nga kjo kategori në këtë periudhë shërbime janë ofruar për njëzetë (20) fëmijë të vënë nën kujdestari, prej tyre shtatëmbëdhjetë (17) janë të strehuar tek të afërmit e tyre të cilët për këtë shërbim marrin një pagesë mujore prej 150 euro, një (1) fëmijë është i vendosur në strehim familjar me pagesë 450 euro në muaj, një (1) në SHFSH dhe një (1) tjetër në familje.

*Fëmijët e strehuar tek të afërmit janë vizituar në familje dhe kemi ofruar edhe shërbime të tjera varësisht nga nevoja.

*Fëmija i vendosur në familje strehuese është vizituar në familje, kemi mbajtur kontakte të kohëpaskohshme me familjet edhe përmes telefonit për ta përcjellë gjendjen e tyre. Ky fëmijë i cili ka status të zgjidhur dhe është potencial për adoptim ndërkombëtar, është propozuar në tri familje potenciale për adoptim ndërkombëtar, por i njëjti është refuzuar për arsye të gjendjes shëndetësore. Për këtë fëmijë, janë ndarë subvencione nga komuna në shumë 1200 euro, e të cilat nga llogaria e kujdestarit ligjor, janë transferuar në llogarinë bankare të familjes strehuese.


*Një fëmijë me nevoja të veçanta e që është i strehuar në Shtëpinë e Fëmijëve me Afësi të Kufizuara Mendore në Shkollë, është vizituar gjatë kësaj periudhe dhe kemi pasur bashkëpunim me stafin e institucionit.

Të gjitha rastet e cekura më lartë, janë raste nga periudha e kaluar dhe vilet paraprake. Prej të gjitha rasteve njëri është ndërprerë nga pagesa në shtator, për shkak të arritjes së moshës madhore.

- **Te delikuenca e të miturve** gjatë kësaj periudhe kemi pranuar dhjetë (10) raste të reja të të miturve në konflikt me ligjin, prej tyre shtatë (7) të paraqitura nga prokuroria për shkak të dyshimit të bazuar për kryerje të veprave penale nga të miturit dhe tre (3) nga gjykata për shkak të kryerjes së kundërvajtjes.

Rastet e dyshuara për vepra penale janë vizituar në familje ku zyrtarët e shërbimit kanë kontaktuar me të miturit dhe prindërit e tyre me qëllim këshillimi dhe udhëzimi për përmirësim të sjelljeve.

Veprat për të cilat dyshohen janë: lëndim i lehtë trupor, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, posedim i narkotikëve dhe asgjësim apo dëmtim i pasurisë.



Rastet që kanë kryer kundërvajtje po ashtu janë vizituar në familje ku janë kështilluar të miturit dhe familjet, dhe pas marrjes së të dhënave të nevojshme janë përgatit Raportet Hetuese Sociale për Gjykatë. Që të gjitha rastet kanë qenë kundërvajtje në komunikacion (pa patent shofer)

Nga këta të mitur tetë raste kanë qenë të grup moshës 16-18 vjeç, ndërsa dy të grup moshës 14-16 vjeç, tetë meshkuj dhe dy femra, që të gjithë të nacionalitetit shqiptar,

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe dy të mitur të cilët e kanë të shquptuar masën edukative të e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e Organit të Kujdestarisë, menaxheret e rasteve i kanë vizituar në familje dhe kanë raportuar me shkrim në gjykatën kompetente.

Gjithashtu kemi pasur edhe raste të asistimit në polici me rastin e intervistimit të të miturve, qoftë si të dyshuar, si viktimë apo dëshmitarë, ku sipas thirrjes së policisë dhe në mungesë të prindit/kujdestarit ligjor, fëmijët janë asistuar dhe përfaqësuar nga zyrtarët e shërbimit social.

- Nga kategoria e **fëmijëve me sjellje asociiale**, kemi pasur shtatëmbëdhjetë (17) raste të reja, ku që të gjithë janë vizituar në familje, kemi intervistuar dhe kështilluar të miturit dhe familjet e tyre dhe kemi bashkëpunuar me shkollat ku ata vijnë mësimet.

Që të gjitha rastet kanë qenë sjellje asociiale në shkollë, të raportuara nga policia dhe shkolla.

Sipas gjinisë pesëmbëdhjetë janë djem dhe dy vajza, sipas nacionalitetit që të gjithë shqiptar.

Varësisht nga natyra e sjelljes asociiale të shfaqur kemi bashkëpunuar edhe me policinë, të cilëve edhe ju është dërguar Shënim Zyrtar lidhur me rastet, si dhe procesverbalet e marrjes së deklaratave për fëmijët nën katëmbëdhjetë vjeç (pa përgjegjësi penale).

- Te kategoria e **fëmijëve me aftësi të kufizuara**, kemi pranuar gjashtë (6) kërkesa të reja nga prindër që kujdesen për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara.

Në këtë periudhë raportuese, janë mbajtur dy seanca vlerësimi të Komisionit Mjekësor shkalla e parë, në QPS Giljan, ku i kemi prezantuar kërkesat e paraqitura, prej tyre tri janë aprovuar, një është refuzuar dhe dy janë në pritje për vlerësim nga komisioni. Rastet e aprovuara janë regjistruar në bazë, janë përgatitur vendimet për palët dhe janë përfshirë në pagesë.

Gjatë kësaj periudhe, kemi pasur kontakte me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, raste aktive të bartura nga e kaluara, shumica e rasteve aktive janë vizituar në familje me qëllim përcjellje të gjendjes.

Tri raste janë ndërprerë nga skema, një për shkak të arritjes së moshës madhore, një për shkak të ndryshimit të vendbanimit dhe një për shkak të kalimit në skemën për paraplegjik/tetraplegjik.

Në fund të kësaj periudhe kohore në pagesë kemi gjithsejtë pesëdhjetenjë (51) raste.

Vlen të ceket se lidhur me këtë kategori klientësh bashkëpunim kemi pasur me zyrtarët kompetent në nivelin qendror.

- Nga kategoria e **fëmijëve të keqtrajtuar** kemi punuar në gjashtë (6) raste, që të gjitha të ndodhura jashtë familjes.

Të gjitha rastet janë vizituar, intervistuar dhe janë ofruar shërbime të nevojshme, ku edhe kemi përgatit raporte me shkrim për policinë dhe prokurorinë.

- Në kategorinë e **çrregullimeve bashkëshortore**, kemi pranuar nëntë (9) raste të reja, tri njoftime nga policia për çrregullim raportesh bashkëshortore, pesë kërkesa nga gjykatara për ndërmarrje të verimeve të tenim pajtimit dhe dhënie të mendimit për besim të fëmijëve dhe një rast i raportuar nga vet pala.

Rastet janë vizituar, intervistuar dhe këshilluar dhe janë përgatit mendimet për besim të fëmijëve në gjykatë.

Po ashtu kemi punuar edhe në raste tjera të bartura nga periudha e kaluar, ku kryesisht kemi prezantuar nëpër seanca gjyqësore, duke elaboruar mendimet e dërguara paraprakisht në gjykatë.

Vlen të ceket se nga rastet e trajtuara, dy prej tyre i kanë sanuar raportet bashkëshortore dhe kanë vazhduar jetën së bashku.

- Kemi punuar në dymbëdhjetë (12) raste të **dhunës në familje**, kryesisht janë raportuar nga policia, përmes raportit ditor të dhunës familjare. Që të gjitha rastet janë vizituar dhe këshilluar nga ana e shërbimit, janë vlerësuar nevojat e tyre dhe janë përgatitë raporte me shkrim për policinë dhe prokurorinë.

Po ashtu në raste të caktuara, kemi marrë pjesë në seanca gjyqësore, ku kemi dhënë mendimin profesional, në procedurë sipas kërkesës për urdhër mbrojtje.

Prej të gjitha rasteve katër viktima janë femra dhe tetë meshkuj. Për nga nacionaliteti, gjashhtë janë shqiptar dhe gjashhtë rom.

- Në kategorinë e **kontakteve femijë prind** kemi punuar në dhjetë (10) raste, shumica raste të vjetra, vetëm dy të reja.

Katër raste i mbajnë kontaktet në ambiente të QPS, të përcjellura me vështirësi të kohëpaskohshme, por kryesisht të tej kalueshme përmes intervenimit të zyrtarëve të shërbimit, të ngarkuar me menaxhim të rasteve.

Tri raste kontaktet i mbajnë jashtë QPS, gjatë vikendeve por pranimi dhe dorëzimi i fëmijëve bëhet përmes QPS.

Në tri raste kemi qenë në proces të ndërmjetësimit mes palëve për të arritur ndonjë marrëveshje për kontaktim, prej tyre dy me element ndërkombëtar.

Përveç këtyre rasteve, shërbime janë dhënë kohë pas kohe edhe për raste të tjera që mbajnë kontaktet jashtë QPS, por që kanë pasur nevojë për ndihmën tonë.

Në këtë kategori bashkëpunim kemi pasur me policinë dhe gjykatën, ku në raste të caktuara sipas nevojës, kemi prezantuar në seanca gjyqësore dhe kemi dhënë mendime profesionale lidhur me procesin e kontaktimit.

- Në kategorinë **personave me retardime mendore** kemi vizituar klientët tanë që ndodhen të strehuar në Shtëpinë e Komunitetit për Persona me Afësi të Kufizuara në Kamenicë ku jemi njoftuar me gjendjen e tyre të përgjithshme

Një klient i cili ka pasur probleme serioze shëndetësore në fund të periudhës raportuese ka ndërruar jetë dhe derisa ka qenë në trajtim mjekësor në QKUK janë dhënë shërbime të nevojshme si pëlqimi për intervenim nga ana e mjekëve specialist, dhe shërbime të tjera rreth ceremonisë së varrimit, gjithnjë në koordinim dhe bashkëpunim me menaxherin e institucionit ku ka qenë i strehuar.

Kemi vizituar tre klient që kemi të strehuar në ISSH, dy në SHFSSH, dhe një në QIRSKP që të gjithë në Shtime.

Nga kjo kategori kemi pasur edhe kontakte me kujdestarë të personave me afësi të kufizuara mendore të cilëve ju është hequr afësia e veprimt.

- Në kategorinë e **personave me sëmundje mendore**, kemi punuar në disa raste , kryesisht të vjetra të bartura nga periudha paraprake, e të cilëve u janë ofruar shërbime varësisht nga nevoja. Një rast të cilit i është hequr zotësia e veprimt, e të cilit po ashtu i është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, bashkë me kujdestarin ligjor(QPS), e kemi dërguar periodikisht në trajtim psikiatrik në QSHM në Gjilan .

Kemi vizituar një klient në Shtëpinë Integruese në Gjilan , ku edhe kemi bashkëpunuar me QSHM.

Një rast i të ri që është paraqitë përgjatë kësaj periudhe i janë ofruar shërbime varësisht nga nevoja, kryesisht përmes referimiti në QSHM dhe Repart të Psikiatrisë.

Një rasti të cilit i është hequr zotësia e veprimit dhe është vënë nën kujdestari të anëtarit të familjes, me kërkesë të këtij të fundit është dhënë leje për kryerje të punëve juridike në procedurë për tjetërsim të pronës që zhvillohet në zyrën e noterit.

- Për një rast të personit me aftësi të kufizuara fizike, kemi pasur kontakte me familjar të tij të cilit janë ankuar për mungesë përkujdesje adekuante të tij nga ana e bashkëshortes e të cilit janë kështilluar për ndjekje të procedurave ligjore.
- Në kategorinë e **personave të moshuar**, kemi bashkëpunuar me zyrtar të SHPMPPF, ku kemi përcjellë gjendjen e rezidentëve tanë të strehuar në këtë institucion, pra tre rezident që kemi pasur, gjatë kësaj periudhe dy prej tyre kanë ndërruar jetë, ndërsa një është vizituar nga zyrtaret e shërbimit me qëllim përcjelljeje të gjendjes.

Kemi ofruar shërbime edhe për klient të tjerë sipas nevojës e që jetojnë në shtëpitë e tyre. Janë vizituar me qëllim përcjelljeje të gjendjes si dhe dhjetë prej tyre me rastin e ditës botërore për të moshuarit janë furnizuar me një shujtë të ngrohë ditore.

Kemi bashkëpunuar me përfaqësues të OIQ “Jetimat e Ballkanit” të cilit janë interesuar për gjendjen e një klienti i cili ka parashtruar kërkesë për strehim në këtë shoqatë. Të njëjtëve u janë ofruar informata të nevojshme përmes anamnezës sociale të përgatitur me shkrim.

- Kemi lëshuar dy (2) **Konstatime Zyrtare** me kërkesë të palëve kryesisht për rregullim dokumentacioni jashtë vendit, me qëllim bashkimi familjar të personave të moshuar me familjar/bijtë në diasporë.
- Kemi lëshuar dy (2) **Pëlqime** për udhëtim jashtë vendit për fëmijë të prindërve të ndarë/shkurorëzuar.

- Shërbimi ka kryer edhe punë administrative; dhënie të vërtetimeve me kërkesë të klientëve, ku gjithsej janë lëshuar dyqindedyzetënjë (241) vërtetime, pesëdhjetedy (52) për fëmijë shtetësie, pesë (5) për lirim nga shtetësia dhe njëqindetëtdhjetëkatër (184) për posedim të zotësisë së veprimt.
- Shërbimi ka menaxhuar bazat e të dhënave, si; Baza e të Dhënave për Shërbime Sociale, Baza e të Dhënave për Fëmijët me Nevoja të Vecanta dhe Baza e të Dhënave për Fëmijët në Strehim Familjar, ku janë regjistruar me kohë rastet, intervenimet dhe janë dërguar me kohë të dhënat në DSHSMF/MD, për administrim të pagesave dhe përcjellje të dukurive të shprehura në komunën tonë.
- Po ashtu janë regjistruar të gjitha rastet dhe intervenimet edhe në Bazën e të dhënave për Viktimat e Dhunës në Familje.
- Kemi mbajtur lidhje të rregullta me DPSSHSMF/MD-në duke dërguar, regjistrat e pagesave për fëmijët që ndodhen në strehim tek të afërmit dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe regjistrat për Panel për fëmijët potencial për strehim e adoptim dhe familjet potenciale strehuese e adoptuese në komunën tonë.
- Pjesëmarrje në takime të rregullta të Panelit për Adoptime në kuadër të Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Mbrojtje të Fëmijëve/Ministria e Drejtësisë.
- Pjesëmarrje në grupe punuese e komisione komunale si: Komisioni për ndarje të subvencioneve në lëmin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Komisioni për ndarje të subvencioneve për të porsalindurit, Komisioni për monitorim të projekteve të bizneseve dhe OJQ-ve, që kanë përfunduar grante dhe subvencione nga komuna, Komisioni disiplinor për shërbesit publik, Komisioni për matje të performances komunale, Komisioni për arkivim të lëndëve, Komisionet për rekrutim të shërbësve civil, Komisioni për inventarizim të asetëve komunale në vlerë nën 1000 euro, Grupi punues për hatim të listës së trezidëve nëpër drejtori, etj.

- Janë kryer punë administrative, si pranim i kërkesave, caktim i menaxherëve dhe ndihmësve të rasit për secilin rast të pranuar, kompletimi i lëndëve me forma profesionale të punës, evidentim nëpër regjistra etj.
 - Organizimi dhe menaxhimi i aktiviteteve në terren dhe pjesëmarrje në terren, goftë si menaxher rasti, apo si ndihmës i kolegeve.
 - Organizim me pjesëmarrje e takimeve dhe mbledhjeve të rregullta mujore të sektorit.
 - Organizim dhe pjesëmarrje në takimet e TNMR-së (Tryeza Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rasteve).
- Në kuadër të kësaj pike, kemi marrë pjesë në trajnime lidhur me organizimin dhe funksionalizimin e TNMR-së, ku edhe i kemi propozuar Kryetari të Komunës përmes DSHMS-së themelimin e kësaj trupe me vendim dhe pas marrjes së vendimit nga Kryetari, kemi mbajtur takime informuese me sektorë që përfshihen në këtë Tryezë dhe kemi ndarë informacione lidhur me obligimet për pjesëmarrje dhe dhënie të kontributit në këtë Tryezë.
- Punë e vazhdueshme me palë, ku janë dhënë këshilla dhe udhëzime varësisht nga nevojat dhe problematika e shtfaqur. Janë asistuar të njëjtit me rastin e hapjes së profilit në platformën elektronike e-Kosova, ku ju kemi ndihmuar për të aplikuar për shtesa për fëmijë, për pagesat për lehona, për aplikim për subvencionim të rrymës, aplikim për skemën e re të asistencës sociale, aplikim për furnizim me libra dhe material shkollorë, e tj.
 - Pjesëmarrje në takime, trajnime e punëtori, të organizuara nga shoqata dhe institucione të nivelit qendror dhe lokal.

*Pjesëmarrje të takimin e Mekanizmit Koordinues kundër dhunës në familje.

*Pjesëmarrje në aktivitete të Ekipit për Mbrojtje të Fëmijëve.

- Kemi mbajtur kujdestarinë pasive njëzet e katër orëshe ku i jemi përgjigjur thirrjeve të policisë pas orarit të rregullit të punës.
- Kemi përgatitur me kohë raportet javore, mujore dhe periodike dhe planet mujore të punës të cilat janë dorëzuar tek udhëheqësi i drejtpërdrejtë.
- Kemi bashkëpunuar me institucionet tjera si me policinë, gjykatat, prokurorinë, QPS-të homologe , QKMF-në, shkollat, QSHM- në, OIQ dhe institucionet tjera komunale.

SEKTORI I SHËRBIMIT TË NDIHMAVE SOCIALE

Në Shërbimin e Sektorit të Ndihmave Sociale në QPS - Kamenicë, punojnë 3 Nëpunës të Ndihmave Sociale dhe Udhëheqësi i ShSNS. Në këtë shërbim punët dhe shërbimet për shfrytëzuesitë ndihmës sociale kryhen konform Ligjit mbi Skemën e Ndihmës Sociale 2003/15, Rregulloren implementuese të këtij ligji, Ligjin nr.04/L-096 për Ndryshimet dhe Plotsimin e Ligjit 2003/15 për SNS, udhëzimeve dhe urdhëresave administrative të nxjerra nga MPPMS respektivisht DPSF-ja. Gjithashtu dhe **Pilot Projekti i SAS-it të ri Ligji për ndihma sociale për vitin 2024 sipas udhëzimeve të MFPPT-së.**

Për të parë dhe analizuar punën e ShSNS-së dhe për të dhënë komente duhet t'i paraqesim në mënyrë tabelare shënimet:

📌 Numri i kërkesave të reja dhe të ripërseritura.

| <i>Muajt e</i> | <i>Kërkesat e reja</i> | <i>Ripërseritje</i> | <i>Të pranuar</i> | <i>Të refuzuar</i> | <i>Komente</i> |
|----------------|------------------------|---------------------|-------------------|--------------------|----------------|
| | <i>Kategoria</i> | <i>Kategoria</i> | <i>Kategoria</i> | <i>Kategoria</i> | |
| | | | | | <i>Shtesë</i> |

| | | | | | | | | | |
|-----------------|----------|-----------|----------|-----------|----------------------|-----------|----------|-----------|--|
| VIII2024 | <i>I</i> | <i>II</i> | <i>I</i> | <i>II</i> | <i>I</i> | <i>II</i> | <i>I</i> | <i>II</i> | |
| <i>Korrik</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>1</i> | <i>0</i> | <i>I+</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | |
| | | | | | <i>Iriaktivizim</i> | | | | |
| <i>Gusht</i> | <i>2</i> | <i>1</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>2</i> | <i>1</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | |
| <i>Shtator</i> | <i>0</i> | <i>1</i> | <i>1</i> | <i>0</i> | <i>I riaktivizim</i> | <i>1</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | |
| <i>Tetor</i> | <i>0</i> | <i>1</i> | <i>2</i> | <i>0</i> | <i>Ikn+1</i> | <i>1</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | |
| | | | | | <i>riaktivizim</i> | | | | |
| <i>Nentor</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>2</i> | <i>0</i> | <i>2 riaktivizim</i> | <i>0</i> | <i>?</i> | <i>0</i> | |
| <i>Dhjetor</i> | <i>1</i> | <i>1</i> | <i>1</i> | <i>2</i> | <i>I+I</i> | <i>3</i> | <i>1</i> | <i>0</i> | |
| | | | | | <i>riaktivizim</i> | | | | |
| <i>Gjithsej</i> | <i>3</i> | <i>4</i> | <i>6</i> | <i>2</i> | <i>4+1 k m 6</i> | <i>6</i> | <i>1</i> | <i>0</i> | |
| | | | | | <i>riaktivizim</i> | | | | |

k m — komisioni mjekësor (shkuresat)

☒ Numri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale dhe shumën e pagesës.

| Muajt e vitit | Nr.familjeve | Pagesa mujore | Antarët e familjes | Komente shtesë |
|---------------|--------------|-----------------|--------------------|----------------|
| 2024 | | | | |
| Korrik | 342 | 39.730.00 | 1232 | |
| Gusht | 342 | 41.300.00 | 1232 | |
| Shtator | 341 | 40.880.00 | 1231 | |
| Tetor | 333 | 39.660.00 | 1199 | |
| Nëntor | 326 | 38.480.00 | 1169 | |
| Dhjetor | ? | ? | ? | |
| Gjithsej | | 200.050.00 euro | | |

☒ Ndërrprerja e ndihmave sociale si dhe lëndet që kanë qenë në komision mjekësor për këtë periode.

| Ndërrprerja e ndihmës sociale | Lëndet në Komision mjekësor në Gjiilan | Komente shtesë |
|-------------------------------|--|----------------|
| | | |

| Muajt e Vitit 2024 | Kategoria | | Kategoria I | | | | |
|--------------------|--------------------|------------|-------------|-----|-----|--------|--|
| | I-të | II-të | gjith | poz | neg | rshqyr | |
| Korrik | 1 atk + 2 | 2 | 10 | 10 | 0 | 0 | |
| Gusht | 1 atk + 2 | 1 | 10 | 10 | 0 | 0 | |
| Shtator | 3 atk + 1 | 1 atk + 2 | 14 | 14 | 0 | 0 | |
| Tetor | 4 | 2 | 16 | 13 | 3 | 0 | |
| Nëntor | 2 k m ? | 0 ? | 18 | 17 | 1 | 0 | |
| Dhjetor | 2 atk + 1 k m + 3 | 3 | ? | ? | ? | ? | |
| Gjithësejt | 7 atk + 3 k m + 12 | 1 atk + 10 | 68 | 64 | 4 | 0 | |

Shkurtimet: atk – agjensioni tatimor i Kosovës

K m – komisioni mjekësor

Ushtrimi i ankesave në shkallën e parë dhe në shkallën e dytë Komisioni i ankesave pranë DMS-së.

| <i>Muajt e</i> | <i>Ankesat në shka- I-rë USNS-së</i> | | <i>Saj janë aprovuar</i> | | <i>Saj janë refuzuar</i> | | <i>Ankesat në DPSP shkallë e II-të</i> | |
|------------------|--|------------------|------------------------------|------------------|--------------------------|-----------|--|-----------|
| | <i>kategoria</i> | <i>kategoria</i> | <i>kategoria</i> | <i>kategoria</i> | <i>I</i> | <i>II</i> | <i>I</i> | <i>II</i> |
| <i>Viti 2024</i> | <i>I</i> | <i>II</i> | <i>I</i> | <i>II</i> | <i>I</i> | <i>II</i> | <i>I</i> | <i>II</i> |
| <i>Korrik</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> |
| <i>Gusht</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> |
| <i>Shtator</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> |
| <i>Tetor</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> |
| <i>Nëntor</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> |
| <i>Dhjetor</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> | <i>0</i> |

| | | | | | | | | | |
|--------------------|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjithësejti | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
|--------------------|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

☒ Riaplikimi i kryer me dokumente të nevojshme.

| | | |
|---------------------------|-----------------------------------|------------------------|
| Muajt e vitit 2024 | Riaplikimi i kryer me kohë | Komente shpresë |
| | K a t e g o r i a | |
| Korrik | 27 | |
| Gusht | 28 | |

| | | |
|------------------|-----|--|
| <i>Shtator</i> | 27 | |
| <i>Tetor</i> | 30 | |
| <i>Nëntor</i> | 43 | |
| <i>Dhjetor</i> | 48 | |
| <i>Gjithësej</i> | 203 | |

Nëse i referohemi tabelave të sipërshënuara shihet se po zvogëlohet numri i familjeve në ndihmë sociale dhe kreujt kjo është si rezultat i kriterëve për ndihmë sociale, si dhe migrimit të popullsisë në qytete të tjera si Gjilan dhe Prishtinë.

Numri i kërkësave do të ishte edhe më i lartë, por me rastin e njoftimit nga NNS për kushtet dhe kriteret egzistuese ligjore një pjesë e tyre heqin dorë dhe nuk aplikojnë, sepse edhe përgatitja e dokumenteve për aplikim kushton.

Numri i kërkesave të riperseritura nga ish shfrytëzuesit e ndihmave sociale është në rritje të ndjeshme, kjo ka ardhur si rezultat i mos gjetjes së ndonjë zgjidhjes tjetër për sigurimin e ekzistencës së familjes.

Ri-aplikimi kryhet me kohë dhe me dokumentacion të parapar me ligj, kontrollohet dokumentacioni nga ana e NNS si dhe nga UShSNS-së e pastaj futen shënimet në bazën e të dhënave.

- Punimi i Listes për kategorione e II-të të shfrytëzuesve të ndihmave sociale për çdo muaj dhe dërgimi në Zyren Komunale të Punësimit në Kamenicë.

- Kthimi i mjeteve të ndihmave soviale sipas ATK-së nga aplikantët: 7 raste

- Kthimi i mjeteve të ndihmës sociale sipas Gjykatës themelore dega në Kamenicë: 1 rast

- Kërkesa për martjen e vërtetimit për nxënës - studentë: 31 raste

- Punimi i Listës për 24 familje (8 shqiptare, 8 serbe, 8 rome) mjete financiare dhe shpërndarja, donator OJQ “ DANISH REFUGEE SOUNCIL “Fondet nga Ambasada Britaneze në Kosovë”

- Pranimi i 3 tableteve për NNS për SAS pilotin e ri të Ligjit për ndihma sociale, nga MFFT-ja

- Aplikimi në e-Kosova, ndihmë aplikantëve nga zyrtarët e e asistencës sociale

- Pilot projekti i SAS-it – Ligji i ri për SAS-in për muajin **gusht 2024**, është punuar në **26 familje** të kontaktuara me telefon dhe të vizituara në teren nga staffi i ShSNS.

- Pilot projekti i SAS-it – Ligji i ri për SAS-in për muajin shtator 2024 është punuar në 63 familje, të kontaktuara me telefon dhe të vizituara në teren nga stafi i ShSNS .

Në muajin tetor kanë përfutuar pagesa te ndihmës sociale 32 familje sipas SAS-it të ri.

- Pilot projekti i SAS-it – Ligji i ri për SAS-in për muajin nëntor 2024 janë punuar në 73 familje, të kontaktuara me telefon dhe të vizituara në teren nga stafi i ShSNS.

- Projekti - Formular verifikues për shtesat e fëmijëve -nga MFPT-ja është punuar nga Stafi i SAS-it gjithsej 15 raste (dërgimi në Prishtinë MFPT, kopjet origjinale 4 herë).

RAPORTI LIDHUR ME SHPENZIMET E DERIVATEVE PËR GJASHTË MUJORIN E DYTË TË VITIT 2024

| <i>MUAJT</i> | <i>BEN. I HARXHUAR</i> | <i>KM.TË KALUARA</i> | <i>SHP.NË100 KM</i> | <i>VËREJTËJE</i> |
|---------------|----------------------------|--------------------------|---------------------|------------------|
| <i>KORRIK</i> | <i>301</i> | <i>492 km</i> | <i>6.09 %</i> | |
| <i>GUSHT</i> | <i>301</i> | <i>377 km</i> | <i>7.95 %</i> | |

| | | | | |
|----------------|------------|----------------|---------------|--|
| <i>SHTATOR</i> | <i>601</i> | <i>955 km</i> | <i>6.28 %</i> | |
| <i>TEKTOR</i> | <i>801</i> | <i>1132 km</i> | <i>7.06%</i> | |
| <i>NËNTOR</i> | <i>401</i> | <i>513 km</i> | <i>7.79 %</i> | |
| <i>DHJETOR</i> | | | | |

DREJTORIA E SHËNDETTËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE - KAMENICË (DSHMS)

**Shtëpia e Komunitetit – Kamenicë
(SHKK)**

Me Marrëveshjen e Mirëkuptimit të lidhur në mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me Nr.220 të datës 14.08.2015, Shtëpia e Komunitetit Për Persona me Afësi të kufizuar Mendore në Kamenicë-Sherbime Sociale Rezidenciale ka kaluar në menaxhimin e Komunës nga data 01.01.2016 respektivisht nën Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirqenie Sociale.

Kapaciteti i këtij institucioni është 10 (Dijetë) persona, kurse të vendosur kemi 11 (njëmbëdhjetë) persona, të cilët janë në qëndrim dhe përkujdesje 24 orëshe.

